



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2024:198661

Datë: 18.11.2024

Numri i dokumentit: 06469712

C.nr.2400/2024

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, si gjykatë civile e shkallës së parë, në përbërje me gjyqtarin, Qëndresa Tahiri-Islami dhe me bashkëpunëtorin profesional, Burim Geci. Në çështjen juridike kontestimore të paditësit V.D, V.T, V.K, V.B dhe V.J, të cilët sipas prokurës më shkrim e përfaqëson avokat Uvejs Gashi, më seli në Mitrovicë, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore. Objekt kontesti “*Kompensim e te ardhurave nga marrëdhënia e punës*”. Jashtë seancë gjyqësore, datë 18.11.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSTATOHET e tërhequr padia më shenjen C.nr.2400/2024, e paditësit V.D, V.T, V.K, V.B dhe V.J, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore.
- II. Secila palë i bartë vetë shpenzimet procedurale.

*A r s y e t i m*

Paditësi, V.D, V.T, V.K, V.B dhe V.J nëpërmes përfaqësuesit të autorizuar, datë 14.06.2024, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore, me objekt kontesti “*kompensimin i të ardhurave nga marrëdhënia e punës*”.

Sipas përshkrimit në padi, paditësit janë në marrëdhënie te rregullt të punës tek tani e paditura, tutje kanë deklaruar se tani paditësit ju është dashur të punojnë edhe gjatë ditëve të shtuna, gjatë pushimeve pranverore dhe i është zgjatur viti shkollor 2022/2023, ndërsa paditësit nuk i kanë realizuar të drejtat e tyre për kompensimin e shpenzimeve në fjalë. I kanë propozuar Gjykatës që kërkesëpadija e paditësit të aprovohet në tërësi e bazuar.

Tutje, përfaqësuesi i paditësit më parashtrësën e datës 13.11.2024, e ka njoftuar gjykatën se tërheq padinë më shenjen C.nr.2400/2024, dhe i ka propozuar gjykatës që padinë e paditësit ta konsideroj të tërhequr.

Gjykata vlerësoi deklarinimin e dhënë nëpërmes parashtrësës nga ana e përfaqësuesit të paditësit të datës 13.11.2024, me çka konstatoi se paditësit tani nuk kanë interes që të vazhdohet tutje.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është bazuar në dispozitat e neneve 450 lidhur me nenin 452 paragrafi 2 të LPK, andaj secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

Andaj, gjykata në pajtim me dispozitat e nenit 261, paragrafi 1, 2, 3, 4 dhe 5 të LPK, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

#### GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.2400/2024, datë 18.11.2024

GJYQTARI

Qëndresa Tahiri-Islami

#### *KËSHILLA JURIDIKE:*

*Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar e drejta e ankesës.*